



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. 1287 Prot.

Fier më 29 /01/2026

Projekt - Vendim

Nr. 18 Dt. 29.01.2026

**“Për miratimin e marrëveshjes së investimit të lidhur ndërmjet Bashkia Fier dhe Fondit Shqipëtar të Zhvillimit për projektin infrastrukturor “ Nderhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , Bashkia Fier”, dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik” me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore për pajisjen me leje infrastrukture .**

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt..../...../2026

, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Hartimit të Projekteve dhe Investimeve Publike , Drejtoria e Menaxhimit të Pronave , Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit , Drejtoria Juridike në lidhje me miratimin e marrëveshjes së investimit të lidhur ndërmjet Bashkia Fier dhe Fondit Shqipëtar të Zhvillimit për projektin infrastrukturor “ Ndërhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , Bashkia Fier” , me treguesit e zhvillimit të propozuar , ku pasqyrohet projekti me nderhyrjet e propozuara , për efekt të vazhdimin të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture si dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të evidentimit të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik”. Ky projekt është miratuar dhe financuar në kuadër të bashkëpunimit institucional me Fondin Shqiptar të Zhvillimit , në kuadër të aplikimit për projekte “ Rigjenerimi urban në zona periferike dhe informale në fshatra me popullsi të dendur etj,Rajonet 3&4 projekt i cili do realizohet në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës së banorëve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave publike ekzistuese duke ndikuar dhe në lehtësimin e trafikut të lëvizjes së mjeteve në zonë .

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “a” dhe gërma “b”, Ligjin Nr.107 , date 31/07/2014 “ Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit , I ndryshuar dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij bazuar në nenin 54, gërma “k”, Kryetari I Bashkisë :

### **Propozon :**

**1-Miratimin e marrëveshjes së investimit të lidhur ndërmjet Bashkia Fier dhe Fondit Shqipëtar të Zhvillimit për projektin infrastrukturor “ Nderhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , Bashkia Fier”, dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik” me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore për pajisjen me leje infrastrukture .**

**2.Të autorizojë ekzekutivin e Bashkisë për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik .**

Drejtoria e Finances Buxhetit dhe Kontabilitetit

P.Çina

Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Ivestimeve Publike

S.Basha

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Dr.F.Troka

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

M.Petushi

Drejtoria Juridike

Dr. E. Kapllanaj

**KRYETARI**  
**Armando Subashi**

